



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:060511

Datë: 20.09.2019

Numri i dokumentit: 00523077

P.nr.989/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENALE, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe me procesmbajtësin Muedin Rexhepi, asistent, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.H. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par. 3 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1898-5/2016 të datës 25.04.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Sebahate Sinani të dëmtuarës H.H., si dhe të akuzuarit Sh. H., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më dt. 19.08.2019 mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 16.09.2019 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: Sh.H. i lindur me date, nga babai B. dhe nëna H. e gjinisë M., me vendbanim në Rr. ”.....”, në Ferizaj, ndërsa me vendqëndrim në W. të Gjermanisë, ka të kryer shkollën fillore, me profesion ndërtimtar, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mban nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 04.10.2016, rreth orës 05:00 në Ferizaj rruga “..”, saktësisht në shtëpinë e tyre në atë mënyrë që pasi i pandehuri ishte kthyer në shtëpi në orët e hershme të mëngjesit i cili kishte konsumuar pije alkoolike, me të hyrë në shtëpi ka filluar ti bërtas të dëmtuarës dhe me

dashje e ka përdorur forcën duke e goditur me shuplaka dhe grushte në fytyrë gruan e tij H. B.

me te ketë ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 par. 3 të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45,49, 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, te akuzuarin Sh.H. e

G J Y K O N

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/, si dhe shpenzimet e procedurës shumën prej 20 Euro /njëzetë/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- E dëmtuara: H.H. me vendbanim në Rr. ”.....” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1898-5/2016 dt.25.04.2017 ka ngarkuar të akuzuarin Sh.H., për veprën penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.08.2019 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *I akuzuari Sh.H. deklaroi se e ndjen veten fajtor dhe e pranoj fajësinë për veprën penale sic më ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saja, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare, pa presion dhe duke i kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, më vjen keq për veprën penale të kryer, i kërkoj falje të dëmtuarës-bashkëshortes sime dhe premtoj se veprime të tilla më nuk do të përsëriten, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.*

E dëmtuara H.H. lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj bashkëshortit tim dhe nuk parashtroj kërkesë pasurore juridike, nga dita kritike më nuk kam pas asnjë mosmarrëveshje fizike dhe verbale, me të njëjtin i kemi dy fëmijë, ndërsa mbajtës i familjes është Shkëlzeni.

Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë lotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të dëmtuarës H.H. e datës 04.10.2016; deklarata e të akuzuarit Sh.H. e dhënë më dt. 04.10.2016, raporti i oficerit 2016-CFT-2351 e datës 04.10.2016 si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës,

-akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 326 paragrafit 1 dhe paragrafi 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: me datën 04.10.2016, rreth orës 05:00 në Ferizaj rruga “.....”, saktësisht në shtëpinë e tyre në atë mënyrë që pasi i pandehuri ishte kthyer në shtëpi në orët e hershme të mëngjesit i cili kishte konsumuar pije alkoolike, me të hyrë në shtëpi ka filluar ti bërtas të dëmtuarës dhe me dashje e ka përdorur forcën duke e goditur me shuplaka dhe grushte në fytyrë gruan e tij H.B..

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sigurtë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, i gjendjes së mesmet ekonomike, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.989/17 datë 16.09.2019.

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Illir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.